

FUNKSIONIM I PARREGULLT I TËRË PRODUKTIT APO I NJË PJESE TË TIJ
NUK MBYLLET PATENTI I VESHJES, KA FEDER I CILI KA DAL NGA VENDI NË DYSHEK, NUK RROTULLOJNË HELIKAT E BRENDSHME NË NDOJË APARAT, NUK FUNKSIONON ZINXHIRI I SIGURISË NË HALLKËN E ARGJENDIT!

Nëse vëreni mangësi të produktit, tregtari duhet t'i mënjanojë mangësitë në afat prej 30 ditësh nga momenti i parashtrimit të kërkesës tuaj ose pas pranimi të aktvendimit nga organi përkatës inspektues me të cilin është urdhëruar që tregtari t'i mënjanojë mangësitë në afat të caktuar.

Për produktet që shërbejnë për përdorim më afatgjatë, tregtari është i obliguar, pas pranimi të kërkesës tuaj, menjëherë t'u dërgojë produkt adekuat të cilin do ta përdorni gjatë periudhës së riparimit të produktit. Në rast të mënjanimi të mangësisë së produktit, afati i garancisë vazhdohet për periudhën kur produkti nuk është përdorur. Kjo kohë përlllogaritet nga dita e kërkesës tuaj për mënjanim të mangësisë.

Në rast të mënjanimi të mangësive, me zëvendësim të produktit që montohet ose është pjesë përbërëse e produktit për të cilin janë përcaktuar afate të garancisë, afati i garancisë për produktin e ri fillon të skadojë nga dita kur konsumatorit i dërgohet produkti mangësia e të cilit është duke u mënjnuar.

Në dyqanet tona hasim në garanci për motor frigoriferësh me afat prej 10 deri 15 vite, motor të makinë për larje prej 7 deri 10 vite, automjete nga 7 vite dhe ngjashëm. Këto janë GARANCI PRODHIMI edhe sipas këtyre garancive i keni të drejtat e njëjta, vetëm me afat më të gjatë nga afati që e jep prodhuesi.

Për PËRPUTHSHMËRI duhet t'i drejtoheni SHITËSIT!
Për GARANCITË KOMERCIALE duhet t'i drejtoheni SHITËSIT!

Nëse nuk bëhet zëvendësim ose nevojitet riparim, për SERVISERËT informohuni mirë kur të blini produkte. Drejttohuni tek SHITËSI! Nëse nuk i plotëson të drejtat tuaja ligjore, mund të drejtoheni në Inspektoratin Shtetëror të tregut apo t'i realizoni të drejtat edhe në procedurë gjyqësore pranë gjykatës kompetente civile!



Për këshilla shitesë në lidhje me të drejtat Tuaja si konsumatorë, mund të drejtoheni tek Organizata e konsumatorëve të Maqedonisë OKM – Shkup, tel. 02/3 179 592 ose nëpërmjet ueb-faqes: www.opm.org.mk
E-mail: sovetuvanja@opm.org.mk



Република Северна Македонија
Министерство за економија

ЏКА DUHET TË
DINI KUR
BLINI PRODUKTE



MËSONI CILAT JANË TË DREJTAT TUAJA NË RAST KUR KENI BLERË PRODUKT JOFUNKSIONAL! ÇFARË TË DREJTA KENI KUR BLINI PRODUKT TË PAPËRSHTATSHËM! TË GJITHA GARANCITË MË TË GJATA SE DY VITE PËR CILËSI APO PJESË TË ÇAKTUARA TË PRODUKTIT JANË GARANCI TË PRODHIMTARISË!

Kur blini produkte, duhet të dini që dispozitat juridike ju mbrojnë në rast se blini produkt jofunksional. Shitësi përgjigjet për vetitë materiale dhe juridike të produktit të cilin e lëshon në qarkullim. Kur themi cilësi juridike të produktit, kjo donë të thotë se ai duhet t'ju shet produkt i cili është nën pronësi të vet dhe të mos jetë i ngarkuar me të drejta të huaja. Shitësi, gjithashtu e ka për obligim të garantojë për vetitë materiale të produktit që donë të thotë se garanton për përshtatshmëri të produktit ose që do të merrni produkt me cilësinë dhe kuantitetin e kërkuar-ofruar dhe nëse bëhet fjalë për produkt të komplikuar, ai duhet të jetë komplet.

Për produkte të caktuara prodhuesit mund të garantojnë veti dhe karakteristika të caktuara për periudhë më të gjatë kohore, ndonjëherë për shkak se bëhet fjalë për produkte të cilat përdoren në ekonomi shtëpiake apo produkte tjera teknike që duhet të kenë garanci periudhë më të gjatë kohore (mbi 5 vite), kurse ndonjëherë për t'u pëlqyer konsumatorëve dhe të krijojnë përparësi ndaj konkurrencës. Kjo garanci është e njohur si garanci e prodhimtarisë!



NË BASHKIMIN EVROPIAN, TREGTARI I JEP LLOGARI KONSUMATORIT PËR MOSPËRPUTHSHMËRI TË MALLIT PËR KONSUM NËSE MOSPËRPUTHSHMËRIA SHFAQET BRENDË DY VITESH NGA DORËZIMI I TË MALLIT. KONSUMATORI DUHET TA NJOFTOJË TREGTARIN NË AFAT PREJ DY MUAJSH PËR MOSPËRPUTHSHMËRINË E VËREJTUR! KUR MANGËSIA SHFAQET NË GJASHTË MUAJT E PARË, KONSUMATORI NUK E KA PATJETLËR TË VËRTETOJË SE FAJTOR PËR MANGËSINË ËSHTË TREGTARI! PËR MANGËSI PAS GJASHTË MUAJSH, KONSUMATORI DO TË DUHET TË VËRTETOJË SE BËHET FJALË PËR MANGËSI TË FSHEHUR! PAS NJOFTIMIT TË TREGTARIT PËR MANGËSINË, KONSUMATORI KA MUNDËSI QË NË AFAT PREJ DY VITESH T'I REALIZOJË TË DREJTAT E TIJ:

1. ZËVENDËSIM APO RIPARIM TË PRODUKTIT;
 2. ZBRITJE PROPORCIONALE TË ÇMIMIT TË PRODUKTIT;
 3. NDËRPERJE TË MARRËVESHJES.
- KONSUMATORI GJITHMONË MUND TË KËRKOJË, SË BASHKU ME NJËRËN NGA KËTO MUNDËSI, KOMPENSIM TË DËMIT NËSE DËSHMON QË AI EKZISTON!

Tregtarët e kanë për obligim të shesin produkte funksionale - kur të lëshojnë në qarkullim produkt jofunksional, ata kanë përgjegjësi për dëmin që mund t'i shkaktojnë konsumatorit dhe personave të tretë.



PRODUKTI NUK ËSHTË FUNKSIONAL KUR NUK E GARANTON SIGURINË TË CILËN ME TË DREJTË E PRET KONSUMATORI, DUKE I MARRË PARASYSH TË GJITHA RRETHANAT, DUKE I PËRFSHIRË:

- A) PREZANTIMIN E PRODUKTIT;
- B) DEDIKIMI PËR TË CILIN NË MËNYRË RACIONALE MUND TË PRITET QË PRODUKTI DO TË ISHTE PËRDORUR;
- C) DATËN E LËSHIMIT TË PRODUKTIT NË QARKULLIM.

PRODUKTI NUK KONSIDEROHET SI JOFUNKSIONAL NËSE ARSYEJA E VETME PËR ATË ËSHTË FAKTI QË PAS TIJ NË QARKULLIM ËSHTË LËSHUAR PRODUKT MË I MIRË.

KUR TË SHPËRTHEJË TELEFONI CELULAR, KUR TË NDIZET INSTALIMI ELEKTRIK NË MOMENTIN E KYÇJES SË APARATIT ELEKTRIK, KUR GISHTAT TUAJ DO TË PËSOJNË PËR SHKAK TË MIKSERIT JOFUNKSIONAL!

Konsumatori duhet të dijë që për produkt jofunksional dhe dëmi që shkaktohet nga produkt jofunksional, prodhuesi ka përgjegjësi nëse dëmi material është më i madh se 500 euro, e dëmi është shkakuar në sendet tjera të konsumatorit, ndërsa për dëm jomaterial, vdekje ose lëndim, sipas normave të përfshira në Ligjin për marrëdhëniet obliguese.

E drejta për garantim të vetive materiale për përputhshmëri mund të realizohet në afat prej 6 muajsh sipas Ligjit për mbrojtje të konsumatorëve (sipas Ligjit për marrëdhëniet obliguese, afati është më i gjatë dhe është një vit).

Kur ekziston mospërputhje e produktit, konsumatori ka të drejtë për: zëvendësim apo riparim të produktit, zbritje, përkatësisht revidim të çmimit, ndërprerje të kontratës dhe në çdo rast, kompensim të dëmit.